

## **PËRMBLEDHJE E PUNËS SË VIZION O.J.F NË SHQIPËRI PËR VITIN 2022 (janar – dhjetor)**

---

Gjatë vitit 2022 shoqata Vizion OJF ka implementuar një sërë projektesh me impakt në fusha të ndryshme të ndara sipas programeve si: edukim/arsim, shëndetësi, fuqizim social-ekonomik i grave dhe vajzave në zonat rurale, turizëm, ndihmë direkte për familjet etj.

Në bashkëpunim me partnerët e saj europian dhe në përputhje me misionin dhe strategjinë afatshkurtër e afatmesëm, projektet kanë dhënë kontribut kryesisht për fëmijët, përmes përmirësimit të kushteve në shkolla e kopshte, për gratë dhe vajzat përmes programeve të edukimit dhe punësimit ose vetëpunësimit, për të rinjtë dhe të rejat në zonat rurale përmes suportit të iniciativave në fushën e turizmit e jo vetëm.

Në vijim po përshkruajmë në mënyrë narrative projektet e implementuara gjatë vitit 2022 dhe impaktin e arritur në komunitet:

### **PROGRAMI: VIZION NË EDUKIM QËLLIMI I PËRGJITHSHËM: NDIKIMI NË EDUKIM, SHKOLLIM DHE SOCIALIZIM NË VITIN 2022**

**Titulli i projektit:** Pajisja me 10 soba të reja për shkollën e Mesme të Bashkuar Perlat  
**Partneri:** Vizion O.J.F  
**Periudha e implementimit:** Shkurt 2022  
**Përfitues direkt:** 132 nxënës, 16 staf mësimor

#### **Përmbledhje e projektit:**

Pas kërkesës së bërë nga drejtori i Shkollës së Mesme të bashkuar Perlat z. Zef Lleshi dt 21.12.2021 për pajisjen e gjimnazit me 10 soba të reja, Shoqata Vizion bëri të mundur pajisjen e shkollës me soba të reja

Sobat u prodhuan duke përdorur duset e dala jashtë përdorimit, duke bërë kështu riciklimin dhe ripërdorimin e tyre. Në Qendrën e re për Trajnim profesional dhe praktika, në Rrëshen, mjeshtri Edi bëri më të mirën e mundshme për të prodhuar sobat për shkollën e Perlatit!

---

**Titulli i projektit:** Pajisja me bazë materiale për çerdhen Shupenzë, Bulqizë  
**Partneri:** Projekt Albanien  
**Periudha e implementimit:** Qershor 2022  
**Përfitues:** 15 fëmijë moshë 6 muaj deri 4 vjeç, 2 edukatore staf

#### **Përmbledhje e projektit:**

Pas kërkesës së bërë nga Bashkia Bulqizë dt 07.04.2022 nr. 2687 Prot për pajisjen e kësaj çerdhe të re e cila do të akomodojë 15 fëmijë, me bazë materiale te domosdoshme, Shoqata Vizion së bashku me Projekt Albanien mundësoi blerjen e bazës materiale si në vijim:

Tavolinë e madhe 1, Portmonto 1, Raftë 2, Tavolina për fëmijë 4, Karrige 20, Ngrohës uji 1, Frigorifer 1, Mokat për ambientin 25 m<sup>2</sup>, Sobë Beko 1  
Në datën 01.06.2022 u bë dorëzimi në këtë çerdhe në prezencën e kryetarit të bashkisë z. Lefter Alla dhe stafit të tij.

---

**Titulli i projektit:** Kopshti i ri Hotesh, Dibër  
**Partneri:** International Projekt Aid (IPA)  
**Periudha e implementimit:** maj - qershor 2022  
**Përfitues:** 20 fëmijë, 1 edukatore, komuniteti i prindërve

**Përmbledhje e projektit:**

Në muajt maj-qershor u ndërtua godina e re, kopsht në Hotesh. Në bashkëpunim me Bashkinë Dibër u lidh Marrëveshja e Bashkëpunimit nr 979 Prot dt 31.03.2022 dhe u mundësua procedura përkatëse administrative për lejet; përkatësisht leja infrastrukturore nr 1206/1 dt 21.04.2022 për ndërtimin e kopshtit të ri. Punimet e ndërtimit përfunduan më 1 qershor dhe gjithashtu u bë mobilimi i ambienteve duke krijuar kështoj kushte komode për zhvillimin e orëve edukative. Ky kopsht është aktiv që më dt 1 qershor dhe vizitohet rregullisht nga 20 fëmijë të zonës. Gjithashtu ambjenti i kopshtit të vjetër, u përshtat për sallë mësuesish dhe shkolla u pajis me libra sipas kërkesës së tyre.

---

**Titulli i projektit:** Përshtatja e një salle të re për mësuesit në Hotesh dhe mobilimi  
**Partneri:** International Projekt Aid (IPA)  
**Periudha e implementimit:** gusht 2022  
**Përfitues:** 22 nxënës, 3 staf

**Përmbledhje e projektit:**

Pas ndërtimit të kopshtit të ri të Hoteshit në verën e vitit 2022, i cili fillimisht e zhvillonte mësimin në një klasë të vogël brenda shkollës fillore të Hoteshit, klasa mbeti bosh. Sipas kërkesës së mësuesve të cilët e kishin të domosdoshme pasjen e një ambjenti të veçantë për mësuesit dhe dokumentet e tyre, ne bëmë të mundur që kjo klasë të përshtatet në klasë mësuesish; u suvatua, u lye, u pajis me derë të re dhe u kthye në një sallë për mësuesit. Salla e mësuesve gjithashtu u kompletua me bazë materiale si: 1 tavolinë, 4 karrige, 1 raft, 1 kompjuter, 1 projektor, 1 ups, 1 tavolinë kompjuteri. Gjithashtu kjo sallë u pajis dhe me një minibibliotekë me 102 tituj librash sipas kërkesës së vetë shkollës.

---

**Titulli i projektit:** Rikonstruksioni total i Shkollës së Mesme të Bashkuar “Dine Hoxha” Muhurr, Dibër  
**Partneri:** International Projekt Aid (IPA)

**Periudha e implementimit:** qershor - shtator 2022  
**Përfitues:** 228 nxënës, 15 staf

**Përmbledhje e projektit:**

Shkolla e Mesme e Bashkuar “Dine Hoxha” në Muhurr përfitoi rikonstruksion total në të dy godinat e saj të cilat ishin në gjendje tejet të amortizuar duke mos plotësuar kushtet bazike higjienike dhe edukative për nxënësit. Në vijim të kërkesës së ardhur nga vetë shkolla dhe interesimi i bashkisë Dibër, si fillim lidhëm kontratën Bashkëpunimi me Bashkinë Dibër nr 3725 prot dt 12.11.2021. Si rrjedhojë bashkia Dibër lehtësoi procedurën e lejeve si; leja e rikonstruksionit nr 1742/1 prot dt 08.06.2022.

Punimet u realizuan për 3 muaj, gjatë verës së vitit 2022. Në përfundim të punimeve, u bë mobilimi i të gjitha ambjenteve të shkollës me: Tavolina, karrige, rafte, kompjutera, projektor, materiale didaktike për të gjitha klasat, materiale sportive etj. Tashmë shkolla ofron kushte komode për nxënësit.

---

**Titulli i projektit:** Ndërtimi i një klase shtesë në shkollën 9 - vjeçare Frankth  
**Partneri:** International Projekt Aid (IPA)  
**Periudha e implementimit:** korrik – gusht 2022  
**Përfitues:** 84 nxënës plus 15 staf

**Përmbledhje e projektit:**

Shkolla 9-vjeçare “Rexhep Kërtuka” në Frankth na shprehu nevojën për një klasë të re për nxënësit e shkollës, sepse klasat aktuale në këtë shkollë nuk mjaftonin për të zhvilluar mësimin të gjithë fëmijët njëkohësisht. Si rrjedhojë një klasë zhvillonte mësimin pasdite, turn i dytë, duke e vështirësuar kësaj procesin e mësimin për nxënësit dhe mësuesit. Për këtë arsye ne dhamë kontributin tonë dhe lidhëm kontratën e bashkëpunimit me Bashkinë Mat si edhe me firmën ndërtuese dhe puna filloi.

Punimet u realizuan në periudhën korrik-gusht 2022. Pastaj u bë mobilimi nga shoqata Vizion me: 8 tavolina nxënësish, 16 karrige nxënësish, 1 tavolinë mësuesi, 1 karrige mësuesi, 1 dërrasë e zezë, 1 sobë, 1 raft. Në inaugurimin e klasës së re, morën pjesë kryetari i Bashkisë Mat dhe stafi.

---

**Titulli i projektit:** Libra dhe printer për bibliotekën e gjimnazit “Rifat Manjani” Shupenzë  
**Partneri:** Projekt Albanien  
**Periudha e implementimit:** Mars 2022  
**Përfitues:** 211 nxënës, 15 staf

**Përmbledhje e projektit:**

Pas kërkesës së bërë nga drejtori i Gjimnazit “Rifat Manjani” Shupenzë Bulqizë z. Arian Kaja dt 11.01.2022 nr 164 Prot për t’i ardhur në ndihme gjimnazit duke pasuruar bibliotekën me tituj aktual librash si edhe me një printer, Shoqata Vizion mundësoi blerjen e një Printer Ricoh MPF

330SN B/W A4 i cili do të përdoret për të mbuluar nevojat e kësaj shkolle. Gjithashtu, u blenë te librari Adrioni 49 tituj librash artistikë sipas listës që kërkoi vetë shkolla.

---

**Titulli i projektit:** Mbështetje me bazë materiale për gjimnazin “28 Nëntori”  
Burrel  
**Partneri:** Projekt Albanien  
**Periudha e implementimit:** shkurt 2022  
**Përfitues:** 285 nxënës, 24 staf

**Përmbledhje e projektit:**

Drejtori i Gjimnazit “28 Nëntori” në Burrel z. Lorenc Leka, na dërgoi një kërkesë për mbështetje dt 01.11.2021 nr 164 Prot në lidhje me situatën e vështirë të krijuar në këtë gjimnaz nga mobiljet e vjetëruara, karrige dhe tavolina të amortizuara. Si rrjedhojë ne dhamë kontribut duke bashkëpunuar me Bashkinë Mat. Së bashku me partnerin austriak Projekt Albanien mundësuam blerjen e 150 suprinave për tavolina dhe 300 karrige dhe bashkia Mat bëri të mundur montimin e tyre, duke përdorur strukturat ekzistuese të hekurit, së bashku me gjimnazistët.

---

**Titulli projektit:** Mbështetje për qendrën ditore të fëmijëve KIDC Korçë  
**Partner:** Projekt Albanien  
**Periudha e implementimit:** 2021 e në vazhdim  
**Përfitues:** 25 fëmijë të qendrës, 1 mësues dhe 6 fëmijë AK që bëjnë terapi

**Përmbledhje e projektit**

Mbështetja për Qendrën KIDC në Korçë ka vazhduar që prej vitit 2021. Shoqata Vizion gjatë vitit 2022 mbuloi koston e psikologes, me pagë mujore e punësuar në Vizion dhe që shërben në qendrën KIDC, dhe koston e terapive të 6 fëmijëve me AK.

---

**Titulli i projektit:** Qendra P.A.M - Vizion Mirditë, qendër multifunksionale për fëmijë  
**Partneri:** Projekt Albanien  
**Periudha e implementimit:** tetor 2021 e në vazhdim  
**Përfitues:** 7 fëmijët që bëjnë terapi, fëmijët 5-14 vjeç, stafi, prindërit, komuniteti

**Përmbledhje e projektit**

Qendra P.A.M –Vizion Rrëshen është një qendër multifunksionale për fëmijë të moshave 5-14 vjeç. Në këtë qendër përveç argëtimit zhvillohen edhe trajnime logopedie, fizioterapie, kurse anglisht, frëngjisht

Në P.A.M janë punësuar 4 gra dhe aktiviteti i përditshëm ofron mbështetje për fëmijët në mësimet shkollore dhe edukim si edhe zhvillohen seanca logopedia e zhvillimi një herë në javë (të shtunave) për fëmijët AK. Gjithashtu falë bashkëpunimit me Drejtorinë Arsimore (ZVAP)

Mirditë, është bërë e mundur që mësuesit ndihmës të shkollave ku fëmijët ndjekin mësimin, të vijnë gjatë seancave të terapive dhe të këshillohen e të zbatojnë planin e zhvillimit të terapistes përgjatë javës. Gjithashtu në qendër ofrohen edhe aktivitete edukative dhe sociale bashkë me vullnetarët gjerman Emily dhe Pius, të cilët aktivizohen dy ditë në javë me fëmijët e qendrës. Gjatë muajve të verës u realizua dhe aktiviteti Kinemaja Verore, një herë në javë si edhe aktivitete të tjera të larmishme social-edukative për fëmijët e Mirditës. Tashmë ky projekt vazhdon të jetë funksional çdo ditë të javës, nga e hëna në të shtunë.

**PROGRAMI: VIZIONI NË TERREN**  
**QËLLIMI I PËRGJITHSHËM: NDIHMË DIREKTE ME PAKO USHQIMORE PËR FAMILJET NË NEVOJË NË ZONA TË NDRYSHME TË SHQIPËRISË.**

Shoqata Vizion me mbështetjen e partnerëve të saj vjen në ndihmë të familjeve në nevojë në zona të ndryshme të Shqipërisë, mesatarisht dy herë në vit, gjatë periudhës mars-prill dhe nëntor-dhjetor. Kryesisht përfitues të Pakove ushqimore janë gratë kryefamiljare, familjet me fëmijë me probleme shëndetësore, familje me të moshuar, në zona të ndryshme të Shqipërisë, pa dallime, bazuar në parime gjithëpërfshirëse.

**Titulli i projektit:** Përkujdesje e vazhdueshme për familjet në nevojë në Mirditë  
**Partner:** Projekt Albanien  
**Periudha e implementimit:** mars - prill 2022 dhe dhjetor 2022  
**Përfitues:** 176 familje, 710 pjesëtarë

**Përmbledhje e projektit:**

Partneri ynë Projekt Albanien edhe këtë vit vazhdoi ndihmën monetare për të bërë realitet shpërndarjen e pakove ushqimore për familjet në nevojë në Mirditë, (2 herë në vit) sipas listës që kemi shqyrtuar në terren, duke shtuar këtë vit edhe 10 familje të reja, në gjendje të vështirë ekonomike.

Shpërndarja e parë konsiston edhe me festën e Pashkës, në muajin prill, si edhe Krishtlindjen në muajin dhjetor, festa që festohen nga besimtarët katolikë, kështu që kjo ndihmë shkon rregullisht edhe si një paketë për këto festa.

Pakot ushqimore llogariten në bazë të numrit të personave në familje për të ofruar kështu një sasi të konsiderueshme ushqimesh. Pakoja përmban ushqimet bazë si: miell, sheqer, oriz, makarona, vaj, fasule, kafe, biskota të përlllogaritura në sasi, sipas numrit të frymëve për çdo familje.

**Titulli i projektit:** Ramazan 2022 Ndhmë për familjet e varfra në zonat rurale të Shqipërisë  
**Partneri:** Muslimehelfen  
**Periudha e implementimit:** prill 2022  
**Përfitues:** 275 familje 5 njësi administrative

**Përmbledhje e projektit:**

Përfitues: 5 Bashki (Krujë, Mat, Bulqizë, Fushë-Arrëz, Dibër), 275 familje, 1056 pjesëtarë, 373 femra, 326 burra, 422 fëmijë minorenë prej të cilëve 38 fëmijë jetimë.

Në periudhën prill 2022, me rastin e festës së Ramazanit, ofruam ndihmë me pako ushqimore për 275 familje në kushte të vështira social-ekonomike në disa Bashki si: Krujë 50, Bulqizë 50, Mat 75, Dibër 60, Fushë - Arrëz 40. Një pako ushqimore për të përballuar jetesën e familjeve në kushte të vështira social - ekonomike të rënduara akoma më shumë nga rritja e çmimeve si pasojë e situatës së luftës në rajon. Periudha e festës së Ramazanit është moment kur familjet presin për t'u mbledhur e për të ndarë së bashku ushqimin në këtë festë të bashkimit të familjes. Shpërndarja në terren e pakove ndihmë është bërë në bashkëpunim me stafet e bashkive përkatëse dhe vullnetarët e Vizion në zonë.

**Titulli i projektit:** Kurban Bajram 2022  
**Partneri:** Muslimehelfen  
**Periudha e implementimit:** 9 korrik 2022  
**Përfitues:** 2 Bashki Dibër, 108 familje, 453 pjesëtarë, 172 femra, 155 fëmijë, 106 burra, 20 jetima

**Përmbledhje e projektit:**

Kurban Bajrami, për shqiptarët është një festë e rëndësishme, ku ushqimi (mishi i kurbanit) ndahet për familjet që nuk kanë mundësi ta përballojnë jetën. Në këtë ditë feste partneri ynë Muslimehelfen Gjermani, mundësoi dhurimin e mishit të Kurbanit për 108 familje në nevojë, në zonën e Dibrës dhe Vorës.

**Titulli i projektit:** Shpërndarja e çantave dhe mjeteve shkollore  
**Partneri:** Muslimehelfen  
**Periudha e implementimit:** Shtator 2022  
**Përfitues:** Kruja 47 fëmijë, Klosi 16 fëmijë, Mati 51 fëmijë

**Përmbledhje e projektit:**

Me rastin e fillimit të vitit të ri shkollor 2022-2023, i cili nisi në 12 shtator 2022, Partneri ynë Muslimehelfen në Gjermani, mundësoi pajisjen me çanta dhe mjete didaktike për 114 fëmijë të familjeve me gra kryefamiljare në zonat; Mat, Krujë, Klos. Të gjithë fëmijët morën dhuratë çantën shkollore dhe mjetet didaktike të nevojshme për vitin e ri shkollor si; fletore, lapsa, stilopasa, vizore etj. Kjo ishte një ndihmë sado e vogël për këto gra kryefamiljare, të cilat na falënderuan për këtë kontribut.

**Titulli i projektit:** Shpërndarja e çantave dhe mjeteve shkollore  
**Partneri:** Projekt Albanien  
**Periudha e implementimit:** Shtator 2022  
**Përfitues:** 54 fëmijë në zonën e Mirditës

**Përmbledhje e projektit:**

Edhe partneri ynë Projekt Albanien, mundësoi pajisjen me çanta dhe mjete didaktike për 54 fëmijë të familjeve me gra kryefamiljare në zonën e Mirditës. Të gjithë fëmijet morën dhuratë çantën shkollore dhe mjetet didaktike të nevojshme për vitin e ri shkollor si; fletore, lapsa, stilopasa, vizore etj  
Fillimi i vitit shkollor, do të jetë më i bukur për ta.

**Titulli i projektit:** Winterhilfe 2022 Ndhimë për familjet e varfra në zonat rurale të Shqipërisë

**Partneri:** Muslimehelfen

**Periudha e implementimit:** dhjetor 2022

**Përfitues:** 6 Bashki (Krujë, Vorë, Klos, Burrel, Dibër, Bulqizë), 400 familje, 1774 pjesëtarë, 471 femra adulte, 596 fëmijë minore, 47 fëmijë jetim, 660 burra

**Përmbledhje e projektit:**

Në muajin dhjetor 2022 me rastin e festave të fundvitit, ofruam ndihmë me pako ushqimore për 400 familje në kushte të vështira social-ekonomike në disa Bashki si: Vorë 50, Bulqizë 50, Klos 50, Dibër 50, Burrel 100, Krujë 100 Një pako ushqimore për të përballuar jetesën e familjeve në kushte të vështira social – ekonomike pas rritjes së çmimeve dhe krizave ekonomike që po kalohen si kudo edhe në Shqipëri. Periudha e festave të fundvitit është momenti kur familjet presin për t’u mbledhur e për të ndarë së bashku ushqimin në këtë festë të bashkimit të familjes.

**Titulli i projektit:** Rivitalizimi i qendrës Kulturore Mat

**Partneri:** Projekt Albanien

**Periudha e implementimit:** prill - korrik 2022

**Përfitues:** 200 fëmijë që frekuentojnë qendrën

**Përmbledhje e projektit:**

“Rivitalizimi i godinës së QKF Mat”, u bë me qëllim nxitjen e edukimit, socializimit dhe kulturës në zonën e Matit, mbi parimet e gjithëpërfshirjes, pa dallime fetare apo politike. Kjo qendër frekuentohet nga 200 nxënës, të cilët marrin mësim në: pikturë, çifteli, fyell e vegla të tjera muzikore. QKF ishte në gjendje të mjeruar dhe ambjentet e brendshme ishin thuajse jashtë funksionit. Por në të njëjtën kohë vëmendja e familjeve, fëmijëve dhe bashkisë ishte tejet e lartë duke e vlerësuar kontributin në këtë qendër si jetik për zonën.

Ky projekt është i bashkëfinancuar në formë donacioni nga Vizion O.J.F me partner Projekt Albanien dhe partner Bashkia MAT, si kontribuuese dhe përfituese. Falë ndihmës së dhënë kjo godinë pësoi rikonstruksion total: dyer dritare të reja, rrjet elektrik, suvatime, pastifikime si dhe u mobilua me: karrige, tavolina, kompjutera, printer, vegla muzikore, materiale didaktike.

**Titulli i projektit:** Qendra e Mekanikës në Rrëshen

**Partneri:** Projekt Albanien

**Periudha e implementimit:** 2021 e në vazhdim

**Përfituesit:** të rinjtë e të rejat moshë 16-24 vjeç

### **Përmbledhje e projektit:**

Projekti ‘Fuqizimi ekonomik i të rinjve në Mirditë përmes metodës “Learning by doing / on job training” që po implementohet në qytetin e Rrëshenit, synon të ngrejë një sipërmarrje sociale që do të kontribuojë në mundësimin e mësimin dhe praktikimit të profesioneve të cilat janë të kërkuara nga të rinjtë dhe të rejtat e zonës, konkretisht: mekanikë, punim druri, punim i hekurit, punim i fijeve të leshit etj për të rinjtë e moshës 16-24 vjeç.

Pas rikonstruksionit të ambjenteve të magazinës dhe pajisjes me materialet e nevojshme për funksionimin sa më të mirë të saj, gjatë vitit 2021, tashmë kanë filluar praktikën profesionale 14 nxënës të Shkollës së Mesme Industriale Rubik, të cilët vijnë 2 herë në javë për të zhvilluar praktikën dhe paguhen për praktikën që realizojnë.

<b>Titulli i projektit:</b>	<b>Dhurim materialesh për Pallatin e Kulturës Rrëshen</b>
<b>Partneri:</b>	<b>Projekt Albanien</b>
<b>Periudha e implementimit:</b>	<b>vazhdimi 2022</b>
<b>Përfituesit:</b>	<b>komuniteti i zonës</b>

### **Përmbledhje e projektit:**

Pas kërkesës drejtuar organizatës “Vizion O.J.F” dt 10.08.2021 nga z. Gjergj Marku drejtor i pallatit të kulturës Rrëshen për të ofruar kushte më të mira për fëmijët dhe për komunitetin, shoqata Vizion bëri të mundur pajisjen e kësaj qendre kulturore me materialet për dhomat e zhveshjes si: Tavolina 2, varëse rrobash 3, Raft rrobash 1, Komo me pasqyrë 1, Kornizë për foto 1, Raft antik 1, Buste 2, Kornizë për fotografi në mur 1, Kornizë për panorama në mur 1, Karrige 9, si edhe për skenën tapiceri shtrimi 70 ml.

Gjithashtu u blenë materiale Forex për fotografitë në mur dhe perde për skenën.

<b>Titulli i projektit:</b>	<b>Ndërtimi/rikonstruksioni i banesës së një familje në Rrëshen</b>
<b>Partneri:</b>	<b>Projekt Albanien</b>
<b>Periudha e implementimit:</b>	<b>dhjetor 2021 – prill 2022</b>
<b>Përfituesit:</b>	<b>një familje, 5 anëtarë</b>

### **Përmbledhje e projektit:**

Pas kërkesës së drejtuar Shoqatës Vizion nga kryefamiljarja e banesës në Rrëshen znj. Anila Dona, banesa e së cilës ishte nisur për t’u ndërtuar me ndihmën e vëllezërve dhe të bashkisë por nuk ishte përfunduar, shoqata Vizion së bashku me partnerin Projekt Albanien Austri, bëri të mundur përfundimin e punimeve për banesën prej 2 dhomash dhe 1 banjë, pajisje hidrosanitare, rregullim korridorit, rregullim tavani, lysterje duke përmirësuar kështu kushtet e jetesës për të gjithë familjen.



**PROGRAMI: VIZION NË SHËNDETËSI**  
**QËLLIMI I PËRGJITHSHËM: PËRMIRËSIMI I SHËRBIMIT SHËNDETËSOR**

**Titulli i projektit:** Furnizimi me bazë mjekësore për Q.SH Ashta, QSh Zojz, Qsh Dragush, QSh Kalivaç  
**Partneri:** International Project Aid (IPA)  
**Periudha e implementimit:** qershor 2022  
**Përfitues:** 4 personel mjekësor, 68 fëmijë dhe 2930 banorë

**Përmbledhje e projektit:**

Prej afro 6 vitesh tashmë ne ofrojmë mbështetje me medikamente për disa qendra shëndetësore në Shqipërinë e Veriut. Edhe në vitin 2022 furnizuam me medikamente për një vit, pra deri në shtatorin e 2023, qendrat shëndetësore në: Zojz, Kalivaç, Dragush, Ashtë, si edhe qendrën e re shëndetësore në Hotesh. Jemi shumë të lumtur të kontribuojmë sadopak në përmirësimin e shërbimit shëndetësor në këto zona dhe lehtësojmë jetën e banorëve të zonës.

**Titulli i projektit:** Ndërtimi i qendrës shëndetësore Zogjaj, Bulqizë  
**Partneri:** International Projekt AID (IPA)  
**Periudha e implementimit:** mars - maj 2022  
**Përfituesit:** 400 banorë të zonës, 1 staf

**Përmbledhje e projektit:**

Fshati Zogjaj në Bulqizë nuk kishte një qendër shëndetësore dhe afro 400 banorët e zonës duhej të udhëtonin për në Shupenzë për të marrë shërbimin parësor shëndetësor. Partneri ynë IPA financoi ndërtimin e Qendrës së re shëndetësore në Zogjaj. Pas lidhjes së marrëveshjes së bashkëpunimit me Bashkinë Bulqizë dhe marrjes së Lejes Infrastrukturore për ndërtimin e godinës së re, filluan punimet. Punimet u kryen nga një skuadër prej 16 punëtorësh. U lidh uji i cili u mor me tubacion nga shkolla afër. Qendra u pajis me 1 krevat pacientësh, 5 karrige, 1 raft, 1 ngrohës, frigorifer si edhe furnizimin me ilaçe e pajisje mjekësore të domosdoshme për funksionimin e saj. Inaugurimi i qendrës u bë në datë 1 qershor 2022

**Titulli i projektit:** Pajisje Grafi X-Ray për Spitalin Bulqizë  
**Partneri:** International Projekt Aid (IPA)  
**Periudha e implementimit:** gusht 2022  
**Përfituesit:** 42.000 banorë, 107 staf i spitalit

**Përmbledhje e projektit:**

Ky është viti i pestë që partnerët tanë zviceranë IPA, ndihmojnë spitalin e Bulqizës.

Këtë herë ky spital u ndihmua me blerjen e pajisjes Grafi digjitale X-Ray e cila do përdoret për t'u ardhur në ndihmë banorëve të zonës.

Grafia digjitale do të shërbejë për diagnostikimin e shumë sëmundjeve sidomos atyre të mushkërive dhe frakturat e ndryshme në rastet e aksidenteve në punë apo automobilistike. Shërbimi do t'u ofrohet të gjithë banorëve të Bulqizës dhe sidomos minatorëve.

## **PROGRAMI: VIZIONI NË FUQIZIMIN SOCIAL – EKONOMIK TË VAJZAVE DHE GRAVE**

**QËLLIMI I PËRGGJITHSHËM: FUQIZIMI I GRAVE DHE VAJZAVE NË ZONA RURALE, POR JO VETËM, PËRMES EDUKIMIT, ORIENTIMIT PROFESIONAL DHE PUNËSIMIT E VETËPUNËSIMIT.**

<b>Titulli i projektit:</b>	<b>Qepja e kostumeve sportive për fëmijët e familjeve në nevojë</b>
<b>Partner:</b>	<b>Projekt Albanien</b>
<b>Periudha e implementimit:</b>	<b>shtator-tetor 2022</b>
<b>Përfitues direkt:</b>	<b>2 artizane</b>

### **Përmbledhje e projektit:**

Ne kemi ofruar bazë materiale si: copa, fije etj. për përkrahjen e 2 artizaneve në Tiranë dhe Vau i Dejës. Ndihma direkte për këto gra u bë dhe në formën e grantimit për artizanet znj. Meliha Zyberaj dhe znj. Vjollca Përshqefa të cilat janë suportuar me grant për mbështetjen e aktivitetit artizanal.

<b>Titulli projektit:</b>	<b>Bursa individuale për vajza dhe shkollimin e tyre</b>
<b>Partner:</b>	<b>International Project Aid</b>
<b>Përfitues direkt:</b>	<b>1 Studente</b>

### **Përmbledhje e projektit:**

Tashmë u bënë disa vite që ne mbështesim financiarisht studenten Anita Kipti nga komuniteti rom, banore e Lezhës, për të mundësuar shkollimin e saj. Këtë vit Anita përfundoi ciklin Master në degën Gjeografi, me rezultate shumë të mira. Shkollimi është një domosdomshmeri për një jetë më të mirë dhe të pavarur. Kur kontribuon në edukimin e një vajze, edukon shoqërinë. Gjatë vitit 2022 ajo u ndihmua me pagesën e kursit të anglishtes të nivelit A2, B1 dhe ndërkohë po bën provimin e licensës dhe pret të fillojë punë dhe të ketë pavarësinë e saj.

**PROGRAMI: VIZIONI AKTIV**  
**QËLLIMI I PËRGGJITHSHËM: KONTRIBUTI NË NISMA INOVATORE TË**  
**HARTUARA DHE IMPLEMENTUARA NGA VETË STAFI I VIZION O.J.F**

**Titulli i projektit:** RINIS 2, program mbështetës i iniciativave të sipërmarrësve të rinj në Veriun e Shqipërisë  
**Partneri:** Projekt Albanien  
**Periudha e implementimit:** Shkurt - qershor 2022  
**Përfitues direkt:** 5 rajone (Mat, Lezhë, Mirditë, Tropojë, Krujë) 10 të rinj e të reja sipërmarrëse

**Përmbledhje e projektit:**

Projekti RINIS- ka në fokus zhvillimin e turizmit, agroturizmit dhe produkteve tradicionale, si dhe ideve inovative dhe synon të mbështesë sipërmarrësit e rinj nga zona e veriut të Shqipërisë, të cilët sapo kanë filluar një sipërmarrje ose janë në fazat e para të zhvillimit të idesë së sipërmarrjes

Ky është viti i dytë që ky projekt vazhdon. Ky program synon të mbështesë sipërmarrësit e rinj nga zona e veriut të Shqipërisë, të cilët sapo kanë filluar një sipërmarrje ose janë në fazat e para të zhvillimit të idesë së sipërmarrjes.

Pasi u bë një përzgjedhje mes 26 aplikuesve, rrugëtimin mundën ta vazhdonin vetëm 10 prej tyre.

U bënë 4 takime në disa qytete si: Korçë, Krujë, Tropojë, Tiranë dhe një sërë takimesh me specialistë të fushës. Konkurentët ndanë eksperiencat e tyre. Finalja e madhe për RINIS 2 u zhvillua në qytetin e Tiranës në datën 21 qershor 2022.

U dhanë 2 Grante prej 1000 dhe 2000 euro dhe një grant 3000 euro (në blerje produktesh) si edhe mbështetja nga Shoqata Vizion e 2 konkurrentëve me 50.000 lekë blerje materiale.

**Titulli i projektit:** Ndhimja për shkollën 9-vjeçare Bllaçe nga Judos Goes Orient  
**Periudha e implementimit:** korrik 2022  
**Përfituesit:** 162 nxënës të shkollës Bllaçe

**Përmbledhje e projektit:**

Shkollën Bllaçe në Dibër, e vizituan përsëri miqtë tanë zvicerian të “Judos Goes Orient”.

Në bashkëpunim me Vizion O.J.F ata e kanë mbështetur këtë shkollë prej disa vitesh.

Kjo shkollë u furnizua me tavolina e karrige të dhuruar nga Organizata Osteuropahilfe “Triumph des Herzens” nën kujdesin e JUDO goes Orient, miq të Vizionit.

Faleminderit dhe Bashkisë Dibër për angazhimin në lehtësimin e procedurave.

Materialet që u sollën janë: 199 karrige, 146 tavolina, 64 pjesë mobiljesh mix.

**Titulli i projektit:** Ndhurma individuale për shkollimin e Markos (i verbër)  
**Partner:** Projekt Albanien  
**Periudha e implementimit:** vazhdimi 2022  
**Përfitues:** 1 nxënës 1 familje

**Përmbledhje e projektit:**

Në vijim të ndihmës për fëmijën e verbër Mark Laska, me terapi individuale dhe me transportin e tij për në shkollë, gjatë vitit 2021 nga stafi i Vizion, këtë vit 2022, ndihma vazhdoi me pagesën e transportit të Markos në shkollë, kjo pagesë i jepet prindit, për t'i lehtësuar sadopak. Falë këtij kontributi Marko mund të ndjekë shkollën në Tiranë.

Gjithashtu Marko frekuenton qendrën tonë PAM në Rrëshen, ku merr pjesë në aktivitete të ndryshme me bashkëmohatarët e tij.

**Titulli i projektit:** Vullnetarizmi në Gjermani  
**Partner:** Sozialer Friedensdienst Kassel e.V  
**Periudha e implementimit:** 2021-2022 vazhdim  
**Përfitues:** 3 vullnetare

**Përmbledhje e projektit:**

Shoqata Vizion së bashku me shoqatën partnere “Sozialer Friedensdienst Kassel e.V.” në Gjermani në kuadër të projektit Vullnetarizmi në Gjermani, mundësoi dërgimin e 3 vajzave vullnetare në Gjermani, të cilat po kryejnë punë vullnetare në disa kopshte të qytetit Kassel. Kjo eksperiencë do t'u shërbejë vullnetareve tona, për ta sjellë edhe në vendin tonë këtë eksperiencë. Kjo përvojë është një mundësi e mirë shkëmbimi eksperience ndërmjet 2 vendeve mike e partnere.

**Titulli i projektit:** Vullnetarët gjermanë në Shqipëri  
**Partneri:** SFD Gjermani  
**Periudha e implementimit:** 31 gusht 2022 – 1 shtator 2023  
**Përfitues:** 2 vullnetarë

**Përmbledhje e projektit:**

Për të ndarë eksperiencën e tyre me ne dhe për të mësuar nga eksperiencia jonë, 2 vullnetarë kanë ardhur nga Gjermania pranë zyrave tona në Vizion.

Ata kanë marrë pjesë në shumë aktivitete që shoqata Vizion ka organizuar në shërbim të njerëzve në nevojë si edhe kanë marrë pjesë në Qendrën P.A.M Rrëshen duke organizuar aktivitete të ndryshme argëtuese si edhe kurse të gjuhës gjermane me fëmijët atje.

**Titulli i projektit:** MAT YESi – More Alternative Towards Youth Education and Social-economic Integration.

**Periudha e implementimit:** 2021- 2023

**Përfituesit:** zona e Matit, studentët që frekuentojne qendrën

**Përmbledhje e projektit:**

Projekti MAT YESi që po implementohet në Bashkinë Mat, është një projekt i financuar nga Bashkimi Evropian. Gjate vitit 2022 Bashkia Mat rikonstruktoi godinën e vjetër të policisë ushtarake dhe e ktheu në Qendër të Formimit Profesional për të rinjtë e të rejtat e zonës së Matit por jo vetëm.

Shoqata Vizion O.J.F si partnere në këtë projekt, organizoi aktivitetet e planifikuara në projekt sipas planit dhe buxhetit përkatës.

Tashmë kanë filluar kurset në 4 degë: kulinari/kuzhinë, mekanik, dizajn, hidraulik.

**Titulli i projektit:** Food bank shpërndarja e farërave

**Partneri:** Food bank

**Periudha e implementimit:** mars - prill 2022

**Përfituesit:** 130 familje

**Përmbledhje e projektit:**

Fondacioni Food banka Albania në bashkëpunim me Vizion O.J.F mundësuan dhurimin e shpërndarjen e 130 pako farërash për 130 familje në zonat: Mat, Dibër, Krujë

Food bank ka qenë suportuese e familjeve në nevojë edhe me pako ushqimore dhe pako higjienike prej disa vjetësh dhe një partnere e mirë e jona.

**Titulli i projektit:** 15 krevate të rinj për kopshtin në Klos

**Partneri:** Projekt Albanien

**Periudha e implementimit:** nëntor 2022

**Përfitues:** 30 fëmijë të kopshtit, 3 staf

**Përmbledhje e projektit:**

Pas kërkesës së bërë nga Bashkia Klos, për pajisjen e kopshtit Klos me 15 krevate marinari për fëmijët që frekuentojnë grupet me ushqim dhe fjetje, Shoqata Vizion së bashku me partnerin austriak Projekt Albanien, mundësoi blerjen e 15 krevateve marinari për këta fëmijë, ndërsa bashkia vetë bëri blerjen e dyshekëve, për ta kompletuar këtë ndihmë.

**Titulli i projektit:** Lyerja e 13 shkollave në bashkinë Bulqizë  
**Partneri:** Projekt Albanien  
**Periudha e implementimit:** gusht 2022  
**Përfitues:** nxënësit dhe stafi i 13 shkollave

### **Përmbledhje e projektit**

Në vijmi të kërkesës së bërë nga Bashkia Bulqizë dt 06.07.2022 nr 4595 Prot, për blerjen e bojërave për lyerjen e 13 shkollave në juridiksionin e Bashkisë Bulqizë, Shoqata Vizion së bashku me partnerin Projekt Albanien, mundësuan blerjen e një sasive bojërash dhe pigmentesh, të cilat u përdorën nga Bashkia Bulqizë për lyerjen e këtyre shkollave, në mënyrë që për vitin e ri shkollor nxënësit të kenë kushte sa më të mira për zhvillimin e mësimin.

**Titulli i projektit:** Ne japim kontribut për Shkollën e Mesme të Bashkuar Muhurr  
**Partneri:** Nisma Vizion për shkollat  
**Periudha e implementimit:** gusht 2022  
**Përfitues:** 228 nxënës, stafi mësimor

### **Përmbledhje e projektit**

“Ne japim kontribut” është motoja e iniciativës që kanë ndërmarrë nxënësit e SHMB Muhurr, Dibër!

Goma makine, litar dhe mbetje të tjera po mirëpërdoren për të shtuar ambjente argëtuese dhe socializuese në oborrin e shkollës! Shoqata Vizion mundësoi blerjen e bojërave për lyerjen e gomave.

Grupi i nxënësve në bashkëpunim me mësuesit dhe banorë të zonës kanë punuar fort dhe tashmë shihen rezultatet e para!

Kreativiteti dhe fryma e grupit mes të rinjve është për t’u lavdëruar.

**Titulli i projektit:** Shpërndarja e dhuratave të Vitit të ri për 117 fëmijë Burrel, Bulqizë Mirditë  
**Partneri:** Projekt Albanien  
**Periudha e implementimit:** dhjetor 2022  
**Përfitues:** 117 fëmijë

### **Përmbledhje e projektit**

Me rastin e festave të fundvitit Vizion O.J.F së bashku me partnerin Projekt Albanien dhuroi pako me dhurata për 117 fëmijë me nevoja të veçanta në Bashkinë Mat, Bulqizë, Mirditë. Në Bulqizë këto dhurata u shpërndanë në qendrën e zhvillimit të fëmijëve.

Në Burrel u dhuruan gjatë një feste të organizuar nga Bashkia Mat me të gjithë nxënësit ekselent dhe nxënësit me nevoja të veçanta.

Gjithashtu janë shpërndarë edhe 100 pako me lodra e çokollata për fëmijët e kopshteve e shkollave në Bulqizë.

**Titulli i projektit:** Dhurimi i pakove me pampers për shtëpinë e foshnjës Tiranë  
**Partneri:** Nisma Vizion  
**Periudha e implementimit:** dhjetor 2022  
**Përfitues:** fëmijët e shtëpisë së foshnjes

### **Përmbledhje e projektit**

Shoqata Vizion në kuadër të ndihmës në shërbim të komunitetit dhe të fëmijëve, dhuroi 55 pako Pampers Babybels 10-15 kg për fëmijët e Shtëpisë së foshnjes “Hannah dhe Rozafa” në Sauk Tiranë. Në këtë fundvit, kjo ishte një ndihmë sado e vogël për këta fëmijë.

**Titulli i projektit:** Festa Mirdita babagysh në Rrëshen  
**Partneri:** Nisma Vizion  
**Periudha e implementimit:** dhjetor 2022  
**Përfitues:** fëmijët e qytetit Rrëshen

### **Përmbledhje e projektit**

Festa Mirdita Babagysh solli sot gëzim në qytetin e Rrëshenit!  
Qindra fëmijë veshur me të kuqe e kapuçë në kokë, mbushën sheshin “Abat Doçi” me këngë, lojëra e të qeshura plot!  
Grupi i animatorëve të ardhur nga Tirana, argëtoi fëmijët me lojëra e këngë.  
Faleminderit të gjithëve ju fëmijë që festuat e na mrekulluat me lumturinë tuaj!